



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ / _____ /2018

V E N D I M

Nr. 46, Datë 7 / 2 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 166, datë 22.12.2017, të paraqitur nga subjekti ankues E.Gj, kundër Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën pretendohet për diskriminim, pa përcaktuar shkakun¹. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga E.Gj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaroi se: “Që nga viti 2008 ka qenë i punësuar pranë Avokatit të Prokurimeve Tiranë, në pozicionin, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Asistencës Ligjore. Mbas mbylljes së aktivitetit të Avokatit të Prokurimeve, Këshilli i Ministrave nxorri Vendimin Nr.80, datë 30.01.2013, i cili detyronte, Agjencinë e Prokurimeve Publike dhe Komisionin e Prokurimit Publik për të punësuar 5 nga inspektorët dhe specialistët e Avokatit të Prokurimeve që kaluan në listë pritje. Me shkresën Nr.22, datë 21.11.2013, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar zbatimin e kërkesave të VKM-së Nr.80, datë 30.01.2013, por Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka kthyer përgjigje”.

Pretendimet që rrjedhin nga moszbatimi i VKM nr.80, subjekti ankues i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me këtë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë me Vendimin Nr.1274, datë 28.03.2014 ka vendosur që KPP të marrë në punë shtetasin E.Gj. Gjykata Administrative të Apelit me Vendimin Nr.4563, datë 22.12.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë për pjesën e marrjes në punë të shtetasit E.Gj. Gjykata e Lartë me Vendimin Nr.348, datë 14.04.2016, ka vendosur, lënien në fuqi të Vendimit Nr.1274, datë 28.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, ku gjykata ka vendosur: “Detyrimin e palës së paditur Komisioni i Prokurimit Publik të zbatojë Piken 3, të Vendimit Nr.80, datë 30.01.2013, të Këshillit të Ministrave "Për rialokimin e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, në vitin 2013", duke marrë në punë shtetasin E.Gj, punonjës civil në listë pritje në kohën e nxjerrjes së aktit nënligjor dhe ekzekutimi i këtij vendimi të bëhet jo më vonë se një muaj nga marrja e vendimit formë të prerë nga përmbauesi gjyqësor”.

¹ Diskriminim lidhur me të drejtën për punësim si rezultat i mosekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.1274, datë 28.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Subjekti ankues, në vijim të ankesës informon se: “Përmbartuesi gjyqsor, ka vijuar me kryerjen e veprimeve përmbartimore, duke njoftuar me shkresën Nr.6675/Prot, datë 12.10.2016, si dhe rinjoftuar me shkresën Nr.7838 prot datë 23.10.2016, palën debitore Komisionin e Prokurimit Publik. Në përgjigje të kërkesës, Komisioni i Prokurimit Publik ka njoftuar ankuesin se i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e vendimit gjyqësor”.

Ankuesi, shprehet se: “Konstatohet lehtësisht se që nga data 14.04.2016, kohë në të cilën Vendimi Nr.1274, datë 28.03.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka marrë formë të prerë dhe deri më sot Komisioni i Prokurimit Publik, pa shkaqe të arsyeshme dhe duke e diskriminur nuk e punëson, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe ka patur vende bosh, si dhe janë krijuar vende të reja pune, duke punësuar persona të tjerë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe vendosjen e sanksioneve administrative ndaj titullareve të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 166, datë 22.12.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, E.Gj është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet mos zbatimit të titullit ekzekutiv, Vendimin Nr.1274, datë 28.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, i ndryshuar me Vendimin Nr.4563, datë 22.12.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë të ndryshuar me Vendimin nr.348, datë 14.04.2016 të Gjykatës së Lartë për marrjen në punë të shtetasit E.Gj si punonjës civil në listë pritje si dhe mos zbatimit të vendimeve të zyrës përmbartimore², që në vitin 2016, periudhë kur E.Gj është vënë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të moszbatimit të veprimeve përmbartimore të mëvonshme.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”*, ankesa nuk

² Njoftim në lidhje me ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr.6675, datë 12.10.2016.

mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje”,* ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së E.Gj, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Rekomandimin e subjektit ankues që pretendimin për diskriminim, ta ndjekë gjyqësisht, në zbatim të nenit 36, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI